



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 02/47
Datë: 15.05.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 maj 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës.
2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

Ministrie e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Ministravo Kulturme, Omladina i Sporta – Ministry of Culture, Youth and Sport

KONCEPT - DOKUMENTI

PËR FILHARMONINË, OPERËN DHE BALETIN E KOSOVËS

Kapitulli 1: Hyrje

Krijimi dhe zhvillimi i politikave, ambientit dhe mekanizmave të përshatshëm për promovimin e kulturës sikurse dhe avancimi i infrastrukturës kulturore me qëllim të krijimit të kushteve adekuat hapësinore, teknike dhe profesionale janë objektiva institucionale dhe njëherazi prioritet afatmesme të parapara dhe në politikat programore si dhe në dokumentet relevante strategjike.

Në këtë kuadër, fusha e kulturës dhe mbështetjes institucionale të saj, paraqitet edhe në kuadër të Vizionit Programor 2017-2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, respektivisht si një ndër katër shtyllat strategjike të këtij vizioni, që kësaj dëshmon për rëndësinë dhe njëherazi përkushtimin institucional për mbështetjen dhe avancimin e sektorit respektiv.

Lidhur me këtë, Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021, në funksion të përkrahes dhe avancimit të sektorit kulturor, ka paraparë një mori masash e objektivash sikurse rishikimi përkatësisht avancimi i kornizës ligjore dhe hartimi i politikave të reja publike që garantojnë pavarësi financiare për institucionet e kulturës dhe menaxhim efikas të përgjegjësi; krijim të politikave të reja kulturore me programe në përkatje të artistëve dhe nismave kulturore, ristikurim dhe riorganizim të institucioneve vartëse për kulturë, promovim të kulturës dhe ngrijes së komunikimit kulturor; edukimit; aftësimit dhe pjesëmarrjes aktive në jetën kulturore.

Një prej gështjeve më të rëndësishme në këtë kuadër mbetet padyshim edhe mbështetja e institucioneve publike të kulturës e me theks të veçantë kapaciteteve njetëzore e institucionale që mbesin parakusht në avancimin e agjendës institucionale për zhvillimin e kulturës në përmbushjen e misionit dhe fushëveprimt të institucioneve kulturore.

Në këtë drejtim, Ministria e Kulturës, Rimisë dhe Sportit në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë tek objektivi *Përkrahja e krijimtarisë kulturore, ndërkombëtarizimi i kulturës* dhe në nën-objektivin *Mbështetja e Institucioneve Publike të Kulturës* përkatësisht Lista e Koncept Dokumenteve për vitin 2018 ka paraparë hartimin e Koncept Dokumentit për Filharmoninë, Operën dhe Baletin si një mundësi e adresimit të gështjeve të listuara përkatësisht defnimit normativ e trajtim adekuat të tyre.

Kapitulli 2: Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemit kryesor

Shpjegim

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008 dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, shumica e ligjeve ekzistuese pësuar ndryshime substanciale bazuar në statusin e ri juridik.

Çështja është se përkundër realitetit të ri, institucionet e Filharmonisë, Operës dhe Baletit Kombëtar të Kosovës ende vazhdojnë së funksionuari sipas Ligjit Nr. 02/L-59 Për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës i aprovuar në Kuvendin e Kosovës në vitin 2006 sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9).

Bazuar në këtë, është domosdoshmëri koherente plotësim ndryshimi i tij për ta harmonizuar me legjislacionin e ri të miratuar nga Kuvendi i Kosovës sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe për t'iu përgjigjur rrethanave të krijuara që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës.

Problemet e identifikuara gjatë zbatimit të ligjit tanimë në fuqi e të evidentuara nga institucionet zbatuese janë si në vijim: përcaktimi i pagartë i kompetencave mes organeve udhëheqëse të institucioneve në fjalë, interferimi në kompetencat mes organeve të lartcekura, pagartësia dhe mungesa e përkufizimeve, përcaktimi i saktë i obligimeve dhe të drejtave të punonjësve artistik, emërtimi i duhur institucional etj.

Plotësim ndryshimin i ligjit aktual të FOB-së paraqitet si nevojë në kuadër të avancimit të kornizës ligjore, prioriteve të Qeverisë së Kosovës si dhe pajtueshmërisë me standardet dhe praktikat evropiane të fushës.

Politika aktuale

Misioni i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është hartimi dhe zbatimi i politikave zhvillimore sipas standardeve evropiane, duke e konsideruar kulturën si një mekanizëm me ndikim të fuqishëm për zhvillimin demokratik të vendit dhe për afirmimin e identitetit kulturor të Kosovës brenda identitetit kulturor evropian.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit gjatë periudhës 2015-2018 në fushën e kulturës ka vazhduar dhe synon të vazhdojë me përкраhjen e institucioneve vartëse të kulturës, përmes investimeve kapitale, plotësimit të infrastrukturës ligjore, subvencionimit të kulturës së pavarur, promovimit të skenës kulturore në ngjarjet e mëdha të kulturës në Evropë dhe botë.

Politikat aktuale të Ministrisë së Kulturës, Riniisë dhe Sportit zhvillohen bazuar në kornizën aktuale ligjore.

Në fushën e Filharmonisë, Operës dhe Baletit është në fuqi Ligji Nr. 02/L-59 për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës i miratuar nga Kuvendi i Kosovës sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9).

Me këtë Ligj ne veçanti rregullohen çështjet si në vijim:

- Themelimi, vazhdimi i punës dhe i veprimtarisë së Filharmonisë, Operës dhe Baletit;
 - Rregullimi dhe organizimi i tyre i brendshëm;
 - Udhëheqja dhe drejtimi i tyre;
 - Statusi, të drejtat dhe detyrat e punonjësve të Filharmonisë, Operës dhe Baletit; dhe
 - Çështjet tjera të rëndësishme për veprimtarinë e Filharmonisë, Operës dhe Baletit.
- Marrë parasysh statusin e ri juridik dhe rrethanat e krijuara që nga shpallja e Pavarësisë së Kosovës dhe hyrja në fuqi e Kushtetutës së Kosovës, vlerësohet se ky ligj nuk është në përputhshmëri me ndryshimet substanciale që kanë pasuar të gjitha institucionet shtetërore në statusin e tyre të ri juridik në përputhje me rrethanat e krijuara dhe hyrjen në fuqi të aktit më të lartë juridik të shtetit.

Ligjet dhe aktet nënligjore

Ligjet:

1. Ligji Nr. 02/L-59 Për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës i miratuar nga Kuvendi i Kosovës sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9).

Aktet nënligjore

1. Statuti i Filharmonisë së Kosovës;
2. Statuti i Baletit Kombëtar të Kosovës;
3. Rregullorja e MKRS-së për pagesat shtesë të artisteve dhe stafit tekniko-artistik të FK-së dhe pagesat e të angazhuarve të tjerë në koncertet e Filharmonisë-Operës së Kosovës;

4. Rregullorja e MKRS-së për pagesat shpesh të artisteve dhe stafit tekniko-artistik të BKK-së dhe pagesat e të angazhuarve të tjerë në shfaqjet e Baletit Kombëtar të Kosovës.

Në bazë të këtij ligji dhe akteve nënligjore janë konstituar dhe funksionalizuar institucionet si: Filharmonia e Kosovës dhe Baleti Kombëtar i Kosovës.

Programi aktual

Programi aktual zhvillohet konform Planit Vjetor të Punës për vitin 2018, dokumenteve strategjike dhe politikave afatmesme të MKRS, në kuadër të cilave janë paraparë aktivitetet që derivojnë nga Ligji aktual i FOB-së.

Në Planin e punës për vitin 2018 janë paraparë këto prioritetet kryesore:

- Përkrahja e zhvillimit të kulturës dhe krijimtarisë kulturore në Kosovë;
- Ndërkombëtarizimi i kulturës përmes pjesëmarrjes në evenimente ndërkombëtare;
- Bashkëpunimi ndërkombëtar i institucioneve kulturore;
- Avancimi i kornizës ligjore dhe formalizimi i bashkëpunimit kulturor me institucionet rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e kulturës;
- Avancimi i veprimtarisë kulturore përmes mbështetjes së aktiviteteve kulturore dhe artistike.

Prioritetet e lartpërmendura janë planifikuar të zbatohen përmes Planit Vjetor të Punës, në bashkëpunim dhe koordinim me institucionet respektive si Filharmonia e Kosovës dhe Baleti Kombëtar i Kosovës.

Shpenzimet aktuale

Bazuar në politikat programore, MKRS/Departamenti i Kulturës bënë mbështetjen institucionale të kulturës.

Lidhur me këtë çdo vit planifikohen dhe ndahen mjete financiare, në kategorinë e subvencioneve, mallrave dhe shërbimeve, komunalive dhe investimeve kapitale, për mbështetjen e këtyre institucioneve kulturore:

1. Filharmonia e Kosovës;

2. Opera e Kosovës;
3. Baleti Kombëtar i Kosovës.

Buxhetet e ndara aktuale për Filharmoninë dhe Baletin Kombëtar të Kosovës janë si në vijim:

Filharmonia e Kosovës		
Buxheti	Viti	Shuma
Pagat dhe mëditjet	2018	393,174.18 €
Subvencione	2018	345,000.00 €
Mallra dhe shërbime	2018	2,933.00 €
Komunali	2018	8,130.00 €
Investime kapitale	2018	/
Buxheti total	2018	749,237.18 €

Baleti Kombëtar i Kosovës		
Buxheti	Viti	Shuma
Pagat dhe mëditjet	2018	140,901.31 €
Subvencione	2018	240,000.00 €
Mallra dhe shërbime	2018	1,560.00 €
Komunali	2018	/
Investime kapitale	2018	/
Buxheti total	2018	382,461.31 €

Vlerësimi plotësues i politikës aktuale

Politika aktuale për mbështetjen institucionale të kulturës është hartuar dhe zbatuar nga ana e MKRRS-së bazuar në ligjin aktual të FOB-së, dhe në bashkëpunim të ngushtë me institucionet: Filharmonia e Kosovës dhe Baletit Kombëtar i Kosovës.

Në politikën aktuale zë vend të rëndësishëm edhe bashkëpunimin ndërkombëtar i FOK-së dhe BKK-së që kanë realizuar me institucionet kulturore simotra në rajon dhe vendet tjera të BE-së.

Duhet cekur se ligji aktual i FOB-së, mbi bazën e të cilit është hartuar edhe politika aktuale në fushën e muzikës artistike dhe baletit, sa më shpejtë duhet ndryshuar me qëllim të harmonizimit me legjislacionin e ri të aprovuar në Kuvendin e Kosovës dhe sipas Kushtetutës së Kosovës.

Plotësim ndryshimi i ligjit aktual do të sjellë ndryshime të rëndësishme pozitive në politikat aktuale dhe në funksionalizimin e këtyre institucioneve, si dhe do të qartësoj edhe me saktësisht përcaktimin e qartë të kompetencave mes organeve udhëheqëse të institucioneve në fjalë, do të adresoj dhe evitoj interferimin në kompetencat mes organeve të lartcekura, do të përcaktoj saktë obligimet dhe të drejtat e punonjësve artistikë, emërtimit të duhur institucional etj.

Lidhur me këtë, rekomandohet Plotësim/Ndryshimi i ligjit në fuqi. Ky Plotësim/Ndryshim do të adresonte çështjen e organeve udhëheqëse të Filharmonisë, Operës dhe Baletit të Kosovës dhe në bazë të vlerësimit të zbatueshmërisë e për më tepër ngeçjeve dhe moszbatueshmërisë së dispozitave përkatëse të ligjit në fuqi rasti i pensionimit të parakohshëm të balerinëve dhe artistëve tjerë si instrumentistët frymor, do të adresohet çështja e gjetjes së mekanizmave përkatës në trajtimin e çështjes në fjalë, përkatësisht pensionimit të parakohshëm.

Sa i përket çështjes së pensionimit të parakohshëm të anëtarëve të trupës së Filharmonisë, Operës dhe Baletit, kërkojmë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që këtë çështje ta trajtoj përmes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, konkretisht rekomandojmë që në kuadër të Ligjit për Skemat Pensionale të Kosovës të parashihet një kategori edhe për anëtarët e trupës së Filharmonisë, Operës dhe Baletit.

Gjithashtu ky plotësim/ndryshim i ligjit do të mundësonte njëherazi që politikat në fushën e kulturës të jenë në përputhje dhe në referencë të veprimtarisë shoqërore dhe ekonomike me fokus stimulimin e krijimtarisë kulturore-artistike dhe zhvillimit të audiencës.

Përvoja në shtetet tjera

Në funksion të harmonizimit dhe përfrimit me praktikën, standardet dhe përvojat e shteteve evropiane në fushën e kulturës, janë konsultuar përvoja dhe korniza ligjore e shtetit sloven dhe atij kroat në fushën e Filharmonisë, Operës dhe Baletit.

Bazuar në rastin e Sllovenisë, përkatësisht organizmit institucional të Filharmonisë dhe Operës në Republikën e Sllovenisë, marrë parasysh këtu dhe harmonizimin e legjislacionit sloven karshi standardeve dhe praktikave evropiane të fushës, vlerësojmë se legjislacioni sloven mbetet shembulli më i mirë dhe i përshatshëm për rrethanat kosovare në kontekst të përditësimit të legjislacionit në fushën e Filharmonisë e Operës.

Lidhur me rregullimin juridik të baletit janë konsultuar gjithashtu disa përvoja dhe korniza ligjore të shteteve rajonale dhe evropiane dhe rasti i Gjermanisë është parë si shembulli më i përshatshëm për rregullimin juridik të Baletit Kombëtar të Kosovës.

Kapitulli 3: Synimet dhe objektivat

Synimi

Përmes plotësim ndryshimit të ligjit aktual të FOB-së, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit synon të krijojë dhe të zhvillojë politika, ambient dhe mekanizma të përshatshëm për zhvillimin dhe promovimin e aktiviteteve të kulturës duke stimuluar krijimtarinë institucionale të Filharmonisë, Operës dhe Baletit Kombëtare të Kosovës.

Objektivat

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka për prioritet krijimin e një mjedisi mbështetës për zhvillimin bashkëkohor të arteve skenike-muzikore e pamore, artit të shkruar, botimit të librave si dhe promovimin e saj me vlera të mirëfillta dhe aftësi konkurruese në vend dhe në arenën ndërkombëtare.

Objektivat e synuara përmes plotësim/ndryshimit të ligjit aktual për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës janë me sa vijon:

1. Avancimi i kornizës ligjore për veprimtarinë institucionale të Filharmonisë, Operës dhe Baletit Kombëtar të Kosovës;

2. Hartimi dhe miratimi i një akti ligjor që i përgjigjet statusit juridik të Kosovës dhe rrethanave të krijuara me rastin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
3. Qartësimi i kompetencave dhe interferimit të tyre mes organeve udhëheqëse dhe pozitës së të angazhuarve, artistëve të institucionit të Filharmonisë, Operës dhe Baletit të Kosovës; dhe
4. Adresimi i gëshitjes së pensionimit të parakohshëm të balerinëve, artistëve dhe instrumentistëve të angazhuar në institucionet respektive, pikërisht kur kihet parasysh fakti që dispozitat ligjore që trajtojnë gëshitjen në fjalë në kuadër të ligjit aktual kanë mbetur të pazbatuara që nga hyrja në fuqi deri më sot dhe rregullimi i së cilës gëshitje është nevojë imediate.

Kapitulli 4: Opsionet

Opsioni i 1. Status quo (asnjë ndryshim)

Nëse nuk ndryshohet ligji aktual, vazhdon të mbetet situata që nuk reflektohen statusin juridik të Kosovës që pas shpalljes dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës dhe njëherazi nuk do të adresonte gëshitje të tilla si, përcaktimi i qartë i kompetencave të organeve udhëheqëse të këtyre institucioneve dhe dispozitave që kanë mbetur të pazbatueshme e që ndërliohen me gëshitjen e pensionimit të parakohshëm të balerinëve, artistëve dhe instrumentistëve.

Opsioni 2. Ndryshimi i politikës ekzistuese

Ndryshimi i politikës ekzistuese do të behet me plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Filharmoninë, Operën dhe Baletin, fillimisht duke e ndryshuar preambulën e Ligjit ekzistues e cila është e bazuar akoma ne bazë të Kreut 5.1 (e) dhe 9.1.26 (a) të Komnizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001), dhe e cila tani duhet të ndryshohet dhe të bazohet ne nenin 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ne plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit ekzistues do të rregullohet edhe emri i Ministrisë se Kulturës, Rinise dhe Sportit, ku nga e emri i Ministrisë do të largohen gëshitjet jo rezidente të cilat sipas Ligjit ekzistues janë në kuadër të këtij institucioni.

Duke plotësuar dhe ndryshuar Ligjin ekzistues do të trajtohet edhe gëshitja e pensionimit të parakohshëm të punëtorëve profesionalë të Filharmonisë, frymorët, Operës solistët vokal, dhe të Baletit solistët e baletit, e cila gëshitje deri më tani ka qenë e rregulluar sipas nent

66 të Ligjit ekzistues por që këtë të drejtë profesionistët e lartëkur nuk e kanë gëzuar asnjëherë. Ne rekomandojmë që çështja e pensionimit të parakohshëm të rregullohet në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale përmes Ligjit për Skemat pensionale të Kosovës.

Po ashtu me plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit ekzistues do të sqarohen mirë kompetencat e stafit menaxhues dhe Këshillave Drejtuese të Instrukcioneve të Filharmonisë, Operës dhe Baletit, si dhe do rregullohet edhe mënyra dhe procedurat e përzgjedhjes së drejtoreshë të këtyre Instrukcioneve e cila procedurë deri me tani ka qenë shumë e pa qartë që në hapjen e konkurseve për zgjedhjen e tyre kemi hasur nëpër shumë vështirësi.

Opsioni i 3. Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit

1. Nëse ligji nuk plotësohet/ndryshohet dhe vazhdohet me zbatimin e politikës ekzistuese, nuk ka alternativ apo mënyrë tjetër për të rregulluar dhe adresuar çështjet identifikuar. Mënyra e ndryshuar e zbatimit të legjislacionit nuk ofron zgjidhje të problemit.
2. Për mos përmbyshje të obligimit të marrë sigurisht se përgjegjës do të ishte fillimisht MKRS, por edhe Qeveria e Kosovës.
3. Trajnimet dhe programet tjera për qasjen ekzistuese të zbatimit nuk do të kanë efekt në adresimin e problemit. Adresimi i problemit bëhet vetëm me plotësim/ndryshimin e ligjit aktual.

Opsionet tjera:

Nuk ka pas dhe nuk ka nevojë për shqyrtimin e opsioneve tjera, të njëjtat do të ishin jo relevante.

Kapitulli 5. Përmbledhje e opsioneve

Përmbledhje e Opsioneve			
Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Karakteristikat kryesore të opsionit	<p>- Ruajtja e status quos</p> <p>- Do të vazhdoj situata që nuk reflektohen statusin juridik të Kosovës që pas shpalljes dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës dhe njëherazi nuk do të adresonte qësitë të tilla si përcaktimi i qartë i kompetencave të organeve udhëheqëse të këtyre institucioneve dhe dispozitave që kanë mbetur të pazbatueshme e që ndërliqhen me qësitjen e pensionimit të parakohshëm të balerinëve, artistëve dhe instrumentistëve.</p>	<p>1. Plotësim/Ndryshimi i Ligjit Nr. 02/L-59 për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës</p>	<p>Politika ekzistuese nuk mund të ndryshohet në mënyrë tjetër.</p>
Segmenti i popullsisë/sectori/rajoni i shënjestruar	<p>- Qytetarët e Republikës së Kosovës</p>	<p>- Qytetarët e Republikës së Kosovës</p> <p>- Filharmonia e Kosovës;</p> <p>- Baleti Kombëtar i Kosovës;</p> <p>- Opera e Kosovës;</p> <p>- Anëtarët e Trupës së Baletit Kombëtar të Kosovës,</p> <p>- Solistët e Trupës së Baletit</p>	<p>- Qytetarët e Republikës së Kosovës</p>

<p>Karakteristikat e zbatimit – kush është përgjegjës – një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët</p>	<p>Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit</p>	<p>Kombëtar të Kosovës; - Anëtarët e Orkestrës Simfonike; - Instrumentistët e Orkestrës Simfonike; - Anëtarët e Korit; - Solistët e Vokalit.</p>	<p>Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit</p>
<p>Administrimi ose zbatimi i programit ose shërbimit</p>	<p>Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit</p>	<p>Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit</p>	<p>Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit</p>
<p>Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimi dhe dënimet</p>	<p>1. Ligji Nr. 02/L-59 për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës i miratuar nga Kuvendi i Kosovës sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9). Aktet nënligjore 1. Statuti i Filharmonisë së Kosovës; 2. Statuti i Baletit Kombëtar të Kosovës;</p>	<p>1. Plotësim/ndryshimi i Ligjit Nr. 02/L-59 për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës</p>	<p>1. Ligji Nr. 02/L-59 për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës i miratuar nga Kuvendi i Kosovës sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9). Aktet nënligjore 1. Statuti i Filharmonisë së Kosovës; 2. Statuti i Baletit Kombëtar</p>

	<p>3. Rregullorja e MKRS-së për pagesat shtesë të artisteve dhe stafit tekniko-artistik të FK-së dhe pagesat e të angazhuarve të tjerë në koncertet e Filharmonisë-Operës së Kosovës;</p> <p>4. Rregullorja e MKRS-së për pagesat shtesë të artisteve dhe stafit tekniko-artistik të BKK-së dhe pagesat e të angazhuarve të tjerë në shfaqjet e Baletit Kombëtar të Kosovës.</p>		<p>të Kosovës;</p> <p>3. Rregullorja e MKRS-së për pagesat shtesë të artisteve dhe stafit tekniko-artistik të FK-së dhe pagesat e të angazhuarve të tjerë në koncertet e Filharmonisë-Operës së Kosovës;</p> <p>4. Rregullorja e MKRS-së për pagesat shtesë të artisteve dhe stafit tekniko-artistik të BKK-së dhe pagesat e të angazhuarve të tjerë në shfaqjet e Baletit Kombëtar të Kosovës.</p>
<p>Stimulimet ose mos-stimulimet ekonomike – subvencionet ose taksat</p>	<p>- Nuk ka ndikime</p>	<p>- Nuk ka ndikime</p>	<p>- Nuk ka ndikime</p>
<p>Fushatat e edukimit dhe komunikimit</p>	<p>- Nuk ka nevojë fushatë komunikimi.</p>	<p>- Komunikimi për koncept dokumentin është bërë duke zbatuar Rregulloren e Punës së Qeverisë së Kosovës 09/2011, janë konsultuar institucionet e përcaktuara me këtë rregullore.</p>	<p>- Fushatat e Edukimit dhe komunikimit bëhen sipas planit të paraparë.</p>

Kapitulli 6: Analiza e opsioneve

Përfitimet

1. Opsioni i 1 (parë), (status quo): Sipas opsionit 1 përfitime do të jenë vetëm ato që kanë qenë gjer më tani, përkatësisht ato që kanë derivuar nga zbatimi i kornizës aktuale ligjore.
2. Opsioni i 2 (dytë): Përmes këtij opsioni, përkatësisht plotësim/ndryshimit të ligjit aktual do të bëhej qartësimi i kompetencave të organeve udhëheqëse të institucioneve në fjalë si dhe do të ofrohej mundësia e adresimit të çështjes së pensionimit të balerimëve, artistëve dhe instrumentistëve të institucioneve në fjalë. Së fundmi plotësimi /ndryshimi i ligjit aktual do të kishte impakt të theksuar në zhvillimin dhe profesionalizimin e këtij sektori duke ofruar mundësi dhe zgjidhje më praktike për avancimin e sektorit në fjalë.
3. Opsioni i 3 (tretë): Nëse ligji nuk plotësohet/ndryshohet vazhdohet me zbatimin e politikës ekzistuese.

Pasojat negative

1. Opsioni i 1 (parë) - Ndikime negative do të evidentohen kryesisht ato që ndërriohen me mosdefinimin dhe përcaktimin e shumë çështjeve të rëndësishme për sektorin përkatës, mos harmonizim me aktet tjera ligjore që janë në fuqi etj.
2. Opsioni i 2 (dytë). - Nuk ka pasoja negative nëse vendoset sipas këtij opsioni.
3. Opsioni i 3 (tretë). - Vlen i njëjti përshkrim i pasojave negative si në opsionin e parë.

Efeku shpërndarës

1. Plotësim/ndryshimit i ligjit aktual sjellë përfitime për institucionet qendrore, lokale, shoqërimë civile e para se gjithash qytetarët e vendit.
2. Përfitimet dhe pasojat negative të elaboruara, lidhur me të gjitha opsionet e konsideruara nuk janë të lidhura me rajone apo pjesë të caktuara të Republikës së Kosovës, por ato kanë efekt të përgjithshëm në tërë territorin e vendit.

3. Ndikimet e opsioneve të konsideruara janë të njëjta për të gjitha moshat dhe veprojnë njëjtë në të dy gjinitë, pra nuk ka efekte dalluese në baza të gjinive apo moshës.

Kosto

Për implementimin e këtyre opsioneve të propozuara nuk krijohen kosto shtesë buxhetore përveç atyre të parapara tashmë me Ligjin mbi Buxhetin për vitin 2018. Vazhdimi i aplikimit të politikave aktuale dhe ndryshimi i politikave aktuale nuk paraqet ndryshime në shpenzimet buxhetore.

Për më tepër, asnjëri nga opsionet e hartuara nuk paraqet diferencë në gjenerimin e të hyrave dhe në alokimin e shpenzimeve.

Kapitulli 7: Konsultimi

Konsultimi me ekspertë, universitete, institucionet kulturore, shoqatat muzikore, kompozitoreve etj.

1. Filarmoninë e Kosovës;
2. Baletin Kombëtar të Kosovës;
3. Fakultetin e Arteve Muzikore;
4. Shoqatën e Kompozitoreve.

Konsultimi me Ministrinë tjera

1. Konsultimet janë zhvilluar me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, lidhur me çështjen e pensionimit të parakohshëm. Gjate tri takimeve që kemi pasur me zyrtaret e kësaj Ministrie kemi diskutuar gjatë dhe në fund kemi ardhur në përfundim që kjo çështje duhet të rregullohet me Ligjin për Skemat Pensionale të Kosovës, ku do të hartohet një grup i përbashkët ndërmnistror dhe do ta plotësojë dhe ndryshonte këtë Ligj dhe ne të të shtohet edhe një skemë me kategorinë krijuese dhe përforcuesve të artit.
2. Si përfundime kanë qenë që ligji aktual duhet të ndryshohet bazuar në praktikën e vendeve të tjera dhe marrjen e praktikave të mira sidomos nga shtetet si Sllovenia dhe Kroacia që kanë krijuar institucione të qëndrueshme të Filharmonisë, Operës dhe Baletit.

Konsultimi me publikun dhe shoqërinë civile:

- Konsultimet kryesisht janë bërë në takimet tona me akterët kryesor të shoqërisë civile dhe shoqatave të fushës së muzikës artistike dhe baletit.

Kapitulli i 8: Krahasimi i opsioneve (Vlerësimi i pasojave të secilit opsion)

Opsioni i dytë është plotësim/ndryshimi i ligjit aktual do të ishte opsioni më i qëlluar dhe i rekomanduar për arritjen e synimit dhe objektivave të parapara në pjesën 3.

Kapitulli 9: Rekomandimi

Rekomandohet:

1. Gjatë rishikimit të kornizës ligjore të kihet parasysh harmonizimi me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet në fuqi; në bashkëpunim me MPPMS-në dhe institucionet relevante të gjenden modalitetet për rregullimin e çështjes së pensionimit të parakohshëm për artistet e FOB-it, adresohet rregullimi i organizimit të brendshëm.
2. Proceduarat për plotësimin dhe ndryshimin do të kryesohen nga ana e Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, në bashkëpunim me institucionet dhe grupet e interesit që të arrihen objektivat e parapara.
3. Brenda tremujorit të parë që nga aprovimi i Koncept Dokumentit në Qeveri duhet të fillojë plotësimi /ndryshimi i ligjit aktual.
4. Nuk do të ketë ndryshime të mëdha në kosto plotësim ndryshimin e ligjit aktual.
5. Nga momenti i aprovimit të koncept dokumentit do të formohet ekipi punues për plotësim/ndryshimin e ligjit, i cili do të përcjell informatat e përditësuara lidhur me procesin e hartimit të projektligjit në fjalë.

Kapitulli 10: Komunikimi

1. Akeretë kryesore të fushës janë në dijeni për fillimin e procedurave lidhur me ndryshimin e ligjit aktual. Ata do të jenë të njoftuar për çdo veprim të ri përmes shkresave zyrtare dhe e-mailave.
2. Me akterët e prekur do të komunikohet bazuar në procedurat e parapara me akte ligjore dhe nën-ligjore, varësisht nga faza e zhvillimit të procedurës.
3. Konsultimet do të realizohen për secilën fazë të procesit, duke filluar nga momenti i aprovimit të koncept dokumentit.

11. Projekt vendimi i Qeverisë

1. Aprovohet Koncept-Dokumenti i për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës.
2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim më Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.